

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEK- Sh.a-Distrikti në Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim B.P. nga Prizreni, kundër të paditurit I.M. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1158/12, të datës 15.10.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13.06.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditëses KEK- Sh.a-Distrikti në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1158/12, i datës 15.10.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1158/12, të datës 15.10.2014, në pjesën e parë të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses KEK- Sh.a-Distrikti në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri I.M. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, që në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike, paditësit t'i paguajë shumën prej 3309.06 euro, si e pa bazuar për shkak të parashkrimit, në pjesën e dytë të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të anuloj aktgjykimin r gjykatës së shkallës së parë në pjesën refuzuese të tij apo ta ndryshoj.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 18.06.2009, në Gjykatën Komunale në Prizren, paditësja në cilësinë e kreditorit ka paraqitur propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit autentik (transaksionet, faturave, ID debitorit), kundër të paditurit në cilësinë e debitorit, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, t'i paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 3.690.65 euro, në kamatë ligjore prej 3.5% duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të propozimit në gjykatë, e deri në pagesën definitive

të borxhit, së bashku me shpenzimet faktike të këtij ekzekutimi, në të kundërtën gjykata do të bëjë përbushjen e ekzekutimit me dhunë, ashtu që sendet e luajtshme të debitorit të regjistrohen, vlerësohen, të sekuestrohen dhe të shiten, e nëse debitori ushtron kundërshtim ndaj këtij aktvendimi, i njëjti do të konsiderohet padi, kurse në rast se pagesa e borxhit së bashku me shpenzimet është bërë në afatin prej 8 ditësh, propozimi për ekzekutim do të tërhiqet.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me aktvendimin Ekz.nr.1139/09 të datës 25.06.2009, e ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin pretendon se aktvendimi me të cilin është lejuar përmbarrimi është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe kontestimore, dokumenti në bazë të së cilit është dhënë aktvendimi për përmbarrim nuk e ka marrë cilësinë e përmbarrueshmërisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1158/12, të datës 15.10.2014, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për shkak të parashkrimit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga leximi i faturës DPZ-42012 e datës 18.06.2009 ka konstatuar se borxhi i përgjithshëm i faturuar në emër të paditurit është 3.735.59 euro, ndërsa nga shikimi në transaksionet e konsumatorit të lëshuar me shifrën DPZ-42012, vërtetohet se borxhi i faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike për periudhën prej datës 12.10.2002 e deri më datë 27.06.2014 është 3.310.42 euro. Ndërsa pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartëcekura gjykatës i rezultoj se borxhi i paditëses KEK Distrikti në Prizren, i faturuar në emër të të paditurit I.M., është faturuar që nga para viti 2002, kurse deri me datë 10.06.2008, borxhi i përgjithshëm i të paditurit ka qenë 3613.59 euro, ndërsa paditësja propozimin për ekzekutim e ka ushtruar me datë 22.06.2009, ku nga kjo rrjedh se kemi të bëjmë me parashkrimin e borxhit, pasi që kanë kaluar më tepër se një vit të shumës se kërkuar me padi, andaj duke marrë parasysh këtë gjendje faktike të vërtetuar, rezulton se i padituri nuk ka për obligim që në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike t'i paguaj paditëses shumën prej 3309.06 euro, pasi që kërkesa për realizimin e këtij borxhi është parashkruar-vjetërsuar konform nenit 378 të LMD-së të vitit 1978, prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve tjera nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjyimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së

Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelsinë e kërkespadiisë e në lidhmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jokontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar pretendimin ankimor të ankuesit se borxhi të cilin ka për obligim ta paguajë i padituri nuk është parashkruar, për çka sipas saj gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar e ka zbatuar të drejtën materiale. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, ku në mënyrë të saktë dhe të plotë janë dhënë arsyet ligjore se pse në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës së paditësit sipas nenin 378 parag.1 të LMD-së. Në këtë drejtim me nenin 378 parag.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (i vitit 1978) parashihet se: *“Parashkruhen për një vit kërkesa e kompensimit për lëvrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë kur lëvrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake”*. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pathemeltë kërkesëpadinë e paditësit për shkak të parashkrimit të kërkesës, pasi që nga shkresat e lëndës, sidomos transaksionet e konsumatorit-të paditurit rezulton se borxhi i të paditurit deri me datë 10.06.2008, ka qenë 3613.59 euro, ndërsa paditësja propozimin për përmbarim e ka parashtruar në gjykatë me datë 22.06.2009, që do të thotë se kërkesa për pagimin e borgjit të faturuar para datës 22.06.2008, është parashkruar konform nenit 378.1 të LMD-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.607/15, datë 13.06.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka